


## Platforma Evropiane e Edukimit Shkollor dhe eTwinning

**Platforma Evropiane e Edukimit Shkollor** është pika e takimit për komunitetin e mësimeve që punojnë në institucionet e edukimit të hershëm, shkollat fillore, shkollat e mesme dhe ato profesionale. Platforma është pa pagesë dhe është shtëpia e eTwinning, komunitetit online për shkollat në Evropë.



Linku: <https://school-education.ec.europa.eu/en>

eTwinning është një komunitet për shkollat, një hapësirë online që ofron mundësi për mësimeve, nxënësit dhe shkollat në të gjithë Evropën për të punuar së bashku në projekte, për të diskutuar në grupe online, për të shkëmbyer praktikën më të mirë dhe për të zhvilluar aftësitë profesionale. eTwinning promovon mësimin e bazuar në projekte, shkëmbimin kulturor dhe qytetarinë dixhitale.

Linku: <https://school-education.ec.europa.eu/en/etwinning>

eTwinning financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Erasmus+, i cili synon të mbështesë arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në Evropë. Nga Janar i vitit 2024 edhe Kosova i është bashkuar komunitetit të eTwinning fal bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë e cila bashkë-financohet programin eTwinning në Kosovë së bashku me Bashkimin Evropian ndërsa implementohet nga Zyra Kombëtare Mbështetëse për eTwinning në Kosovë. Kosova i është bashkuar komunitetit të më shumë se 40-të vendeve duke përfshirë shtetet anëtare të BE-së, si dhe disa vende jo anëtare të BE-së që marrin pjesë në eTwinning.

Në qershor të vitit 2024, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në Kosovë është bërë edhe lancimi zyrtar i programit eTwinning në Kosovë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Znj. Arbërie Nagavci, Z. Johannes Madsen - udhëheqës për bashkëpunim nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Znj. Mimika Dobroschi - koordinatore e zyrës Erasmus+ në Kosovë.



Në event ishin pjesëmarrës edhe zyrtar nga MASHTI, zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, drejtoritë komunale të arsimit në Kosovë, fakultetet e edukimit, media, etj.

Anëtarësimi në komunitetin eTwinning u ofron shkollave dhe mësimeve në Kosovë përfitime të shumta:

- **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Shkollat mund të angazhohen në projekte bashkëpunuese me partnerë nga Kosova dhe nga vende të tjera, duke pasuruar përvojat e mësimeve dhe nxënësve;
- **Mësimi i avancuar:** projektet eTwinning promovojnë të mësuarit aktiv, të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve përmes aktiviteteve praktike, ndërkulturore, etj.
- **Zhvillimi Profesional:** Mësimeve dhe stafi i shkollës mund të kenë akses në burime të shumta informacioni, mundësi trajnimi dhe mbështetje për të përmirësuar praktikën e tyre të punës dhe për të qëndruar të përditësuar me trendet arsimore.
- **Shkëmbimi kulturor:** Mësimeve dhe nxënësit kanë mundësinë të ndërveprojnë me partnerët me prejardhje të ndryshme kulturore, duke nxitur mirëkuptimin dhe tolerancën.
- **Integrimi i TIK-ut:** eTwinning inkurajon përdorimin e teknologjisë në arsim, duke ndihmuar shkollat të përdorin mjetet dhe burimet dixhitale për të përmirësuar mësimin dhe të nxënësit.
- **Njohja dhe Çmimet:** Mësimeve mund të marrin mirënjohje dhe vlerësime për projektet e tyre eTwinning në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Visioni është që të përfshihen të gjitha shkollat nga zona urbane dhe rurale në Kosovë në komunitetin eTwinning dhe në këtë mënyrë sistemi i edukimit në Kosovë të jetë në hap më afër atij evropian.